



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Datë/a:	19.05.2021
Referenc-ë:	07-353/04-75382/21
Për/ Za/ To:	“PRIFEST”- Vjosa Berisha
Përmes/Preko/Through:	Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Nga/ Od/ From:	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrolloi: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
Tema/ Subjekat/Subject:	Pëlqim

Drejtorija për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën me nr. protokolli 07-353/04-75382/21 nga “PRIFEST” me përfaqësuese Vjosa Berisha – Drejtore e festivalit Prishtina International Film Festival me të cilën kërkohet shfrytëzimi i hapësirës publike në këto lokacione:

1. Hapësira para Teatrit Kombëtar nga data 21 deri më 30 Gusht;
2. Hapësira te sheshi “Zahir Pajaziti” nga data 22 deri më 30 Gusht;
3. Hapësira e Amfiteatrit të Muzeut Kombëtar nga data 24 deri më 29 Gusht;

Qëllimi i kërkesës është mbajtja e festivalit të filmit “ Prishtina International Film Festival”- PRIFEST festival ky që sivjet shënon edicionin e tij të 13-të..

Drejtorija pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës publike në lokacionet e kërkuara sipas kërkesës së parashtruar.

Kushtet e pëlqimit:

- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.